

Për: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Vushtrrisë

Lënda: Komente lidhur me Njoftimin publik nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - Komuna e Vushtrrisë, datë 14.06.2017

Nga: Banorët e lagjes – rruga Avni Rrustemi, Vushtrri

Datë: 27.06.2017

Si familje me banim në lagjen - Rr. Avni Rrustemi në Vushtrri, në hyrje të së cilës është vendosur "Njoftim Publik" (dt. 14.06.2017) nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - Komuna e Vushtrrisë, lidhur me aplikacionin e kompanisë TRADITA Shpk për caktimin e kushteve ndërtimore dhe dhënjen e lejes ndërtimore për ndërtim të objektit: Afarist-Banesor B+P+5, në parcelat kadastrale P- 70202016-039949-0 , e ku është dhënë mundësia e paraqitjes së komenteve ndaj lëndës së sipërcekur, duam të ju sjellim parasysh si vijon:

Tashmë është vërtetuar se Njoftimi Publik dhe dhënja e mundësisë për paraqitjen e komenteve lidhur me aplikimet për caktimin e kushteve ndërtimore dhe dhënjen e lejes ndërtimore për ndërtimin e objekteve Afariste - Banesore po bëhet vetëm sa për formalitet apo siq thotë populli "sa për sy e faqe", duke shpërfillur dhe injoruar plotësisht vullnetin e komunitetit lidhur me mjedisin e tyre jetësor.

Po shihet qartazi se autoritetet përgjegjëse për urbanizëm dhe mjedis jetësor po i japin perparësi interesave dhe perfitimeve të individëve në dëm të interesit të përgjithshëm të komunitetit. Me vetëdije dhe për perfitime individuale po shkatrohet pjesa më e mirë e qytetit. Dhe, kjo nuk është dashtë dhe nuk duhet assesi të lejohet nga autoritetet komunale.

Po ju rikujtojmë rastin e Njoftimit Publik datë 26.08.2016 të vendosur në rrugën Avni Rrustemi nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - Komuna e Vushtrrisë, lidhur me Aplikacionin e SH.P.K. TRADITA për Caktimin e Kushteve Ndërtimore në parcelen kadastrale P-70202016-2369-5; 2369-10; 2369-11, për ndërtimin e Objektit për Banim (B+P+5), në Rrugën Avni Rrustemi, në Vushtrri,

Në atë rast, përkundër shprehjes së mospajtit dhe kundërshtimit gojor dhe me shkrim (Lënda me nr. 08-007- 47469, datë 13.09.2016) si dhe peticionit nga ana e komunitetit-banorëve të Lagjes, është lejuar ndërtimi i objektit Afarist-Banesor me çka është shkelur rëndë e drejta jonë e garantuar kushtetuese për të ndikuar në vendimin që ka pasur të bëjë me mjedisin tonë jetësor.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]

2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.

Ajshë Dalku
Dalku

B. J. J. J.
J. J. J.

3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.

Tani kur është duke ndodhur ndërtimi i objektit Afarist -Banesor në parcelen kadastrale P-70202016-2369-5; 2369-10; 2369-11, kundër vullnetit të komunitetit-banorëve të lagjes-rruga Avni Rustemi dhe rruga Vëllezërit Frashëri, mjedisi ynë jetësor është cënuar seriozisht!

Ja disa nga pasojat që po i vuajmë padrejtësisht ne si banorë të atyshëm:


- Është shkatërruar rruga nga qarkullimi i automjeteve të rënda dhe si rrjedhojë e dëmtimeve të mëdha është vështirë të qarkullohet me vetura si dhe bëhet shumë pluhër i cili po na sjell probleme serioze gjatë lëvizjes tonë, si problemin e frymëmarrjes, ndotjen e veshëmbathjeve, veqmas rrezikohen fëmijet dhe të moshuarit,
- Nga pluhuri që bëhet nuk kemi mundësi të hapim dritaret e shtëpive për ajrosje, sepse na deperton pluhuri brenda në shtëpi dhe kjo na sjell shume telashe dhe shpenzime për mirëmbajtje dhe pastrim!
- Bëhet shumë zhurmë gjatë punimeve, si gjatë ditës ashtu edhe në orët më të hershme të mëngjesit, madje edhe gjatë të dielave dhe kjo na sjell shumë shqetësime dhe bezdisje,
- Bllokohet rruga me makineri të rënda duke penguar lëvizjen e lirë dhe të sigurt të banorëve të lagjes, posaqërisht të fëmijëve,
- Punohet pa kurrfarë mase mbrojtëse dhe të sigurisë, gjë që paraqet rrezik serioz, si për banorët kalimtar, poashtu edhe për puntorët e ndërtimit, (bashkengjitur janë dëshmitë)

Duam të i'u kujtojmë se cënimi i interesit të pergjithshëm të komunitetit dhe shkelja e Kushtetutës janë vepra të sankcionueshme!


Prandaj, bazuar në gjithëçka u cekë më sipër, e shprehim mospajtimin dhe kundërshtimin tonë plotë ndaj lejmit të ndërtimeve të objekteve Afariste - Banesore në lagjen tonë.

Me respekt,

1. Besim Jashari me familje, banorë të lagjes,rruga Avni Rustemi,



2. Arsim Dallku me familje, banorë të lagjes-rruga Avni Rustemi





Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUMM)

Në bazë të Udhëzimit Administrativ (UA) mbi kërkesat për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore dhe për lëshimin e kushteve ndërtimore dhe lejeve ndërtimore, DUMM harton këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Në komunën e **Vushtrrisë** është dorëzuar aplikacioni nga **TRADITA shpk – Elver Zairiqi** për caktimin e Kushteve Ndërtimore për parcelat kadastrale **P-70202016-03949-0** me sipërfaqe prej **1071m²**.

Në aplikacion kërkohet të caktohen kriteret për ndërtimin e objektit: **Afarist-Banesor B+P+5**.

Data e njoftimit: **14.06.2017**.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më: 28.06.2017 në zyret e DUMM-së.

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Sipas PZHK-së dhe PZHU-së	
b. Vija rregulluese.	Sipas PZHK
c. Vija e ndërtimit.	9.5.0m'
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	(B+P+5); min. 1.0 H
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	4.5m' ; 7.60m'; 7.70m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	44%
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	56%
h. Përqindja e sipërfaqes bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	ISD 2.75
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	44%
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	31
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese.	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Me Izolim Termik
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjeneroj ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
nj. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	